



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 69, datë 15.07.2020

PËR

MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË NDËRTESESË SË ADMINISTRATËS TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MANËZ, BASHKIA DURRËS, PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE PËRBËN RREZIK SHUMË TË LARTË PËR JETËN DHE SHËNDETIN, DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR E KRYER NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË, SI DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA LISTA E VEÇANTË E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE DHE KONTABILITETI, TË NDËRTESESË SË NJËSISË ADMINISTRATIVE MANËZ

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjt nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Vendimit nr.500, datë 14.8.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr. 959 prot., datë 04.05.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt ekspertize”, Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018 “Për



kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës së administratës të Njesisë Administrative Manëz, Bashkia Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe përbën rrezik shumë të lartë për jetën dhe shëndetin, dhe është rekomanduar të priset, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, e kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista e veçantë e inventarit të pronave të paluajtshme publike dhe kontabiliteti, të godinës me emërtimin “ndërtesa e Bashkisë Manëz”, pronë e Bashkisë Durrës.
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me emërtimin “ndërtesa e Bashkisë Manëz”, që me VKM nr. 500, datë 14.8.2001, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e ndërtesës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e ndërtesës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e ndërtesës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e godinës, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.



7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Ligjore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 15.07.2020



0113/3

2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 643 / prot.
/ 2

Durrës, më 17.07.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 69 datë 15.07.2020 “Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës së administratës të Njesisë Administrative Manëz, Bashkia Durrës, për shkak se është e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26.11.2019 dhe përbën rrezik shumë të lartë për jetën dhe shëndetin dhe është rekomanduar të priset, kjo sipas Aktekspertizës së thelluar e kryer nga instituti i ndërtimit Tiranë, si dhe miratimin për heqjen nga lista e veçantë e pronave të paluajtëshme publike dhe kontabiliteti, të ndërtesës së Njesisë Administrative Manëz”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

